



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



RR E G U L L O R E
PËR
SHËRBIMIN E TRANSPORTIT ME “MERIMANGË” NË TERRITORIN E
KOMUNËS SË PRISHTINËS

Prishtinë, 2010

Bazuar në dispozitat e nenit 96, 99, 100, 101 dhe 102 të Ligjit nr. 02/L - 70, për sigurinë në komunikacionin rrugor, të nenit 17, pika 17.1, shkronjat **f** dhe **n** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të nenit 6 të Ligjit nr. 2004/1, për transportin rrugor, të nenit 12 të Udhëzimit administrativ nr. 02/2009 - PK dhe të dispozitave të nenit 33, pika 33.1, shkronja a të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 20.5.2010, miratoi

R R E G U L L O R E N
P Ë R
SHËRBIMIN E TRANSPORTIT ME "MERIMANGË" PËR TERRITORIN E
KOMUNËS SË PRISHTINËS

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

Në bazë të kësaj Rregulloreje, rregullohen kushtet dhe mënyra e zhvendosjes së automjeteve të ndaluara ose të parkuara në rrugë, apo në hapësira tjera të ndaluara, ku rrezikohet siguria në komunikacion ose pengohet rrjedha normale e komunikacionit dhe ushtrimi i shërbimit të transportit me "merimangë" në territorin e komunës së Prishtinës.

Neni 2

2.1. Shërbimi i transportit me "merimangë", nënkupton tërheqjen - bartjen e automjeteve të marra nga vendet ku është i ndaluar parkimi i tyre, nga vendet ku ka ndodhur aksidenti në komunikacion, automjetet që mund të jenë të braktisura dhe në raste të tjera, dhe vendosja e tyre në vendin e caktuar për këtë qëllim.

2.2. Pas konstatimit të shkeljes së rregullave në komunikacion, të evidencuar nga personat kompetent, se automjeti është ndaluar apo parkuar në mënyrë jo të rregullt, ai tërhiqet në bazë të urdhëresës së zyrtarit policor dhe kërkesës së personit të autorizuar nga organi i Komunës së Prishtinës.

2.3. Para se të jepet urdhëresa për zhvendosjen e automjetit, sipas paragrafit paraparak të këtij neni, pozita e automjetit të ndaluar ose parkuar në mënyrë jo të rregullt, dëshmohet me fotografi ose me skicë .

2.4. Vendin (lokacionin) për vendosjen e automjeteve në autopark, nga paragrafi paraparak, e cakton Kuvendi i Komunës.

Neni 3

Zhvendosja dhe bllokimi

3.1 Tërheqja - bartja e automjeteve bëhet me urdhër dhe nën kontrollin e Policisë, të inspektorit komunal të komunikacionit, duke konstatuar gjendjen e automjetit para se të lëshohet urdhëresa për tërheqje.

3.2 Automjetet e ndaluara ose të parkuara në mënyrë jo të rregullt zhvendosen, ndërsa autobusët, automjetet transportuese, makinat dhe automjetet e punës dhe rimorkiot, bllokohen dhe tërhiqen në bazë të urdhëresës së zyrtarit policor dhe kërkesës së personit të autorizuar nga organet e Administratës komunale: inspektori i komunikacionit apo inspektori komunal, në bashkëpunim me Policinë.

3.3. Automjeti që nuk kërkohet të tërhiqet nga pronari (drejtuesi i automjetit), sipas nenin 2.1 të kësaj Rregulloreje, në afatin prej gjashtë muajsh nga dita e vendosjes në atë vend, me ligj, neni 10.1, automjeti do të shitet në ankand publik dhe të hollat do të derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

3.4. Nëse automjeti, pas tri ankandeve publike, nuk mund të shitet, ai duhet të asgjësohet, në bazë të vendimit të cilin e nxjerr një komision i veçantë, i cili formohet nga Komuna, Policia e Kosovë dhe Dogana e Kosovës.

3.5. Operatori i transportit me "merimangë", do të caktohet përmes tenderit të shpallur për kryerjen e shërbimeve të transportit me "merimangë", në bazë të kushteve më të volitshme të ofruara.

3.6 Ndërmarrja biznesore e licencuar nga Komuna për zhvendosjen e automjeteve duhet t'i ketë edhe pajisjet për bllokimin e automjeteve.

Neni 4

4.1. Komuna do të lidhë kontratë me operatorin e transportit - fituesin e tenderit për transport me "merimangë", me të cilin do t'i përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese.

4.2. Kontrata nga paragrafi paraprak, lidhet për kohë të caktuar deri në një (1) vit, me mundësi vazhdimi.

Neni 5

5.1. Në momentin e tërheqjes - marrjes së automjetit nga operatori, përveç dëshmisë së pagesave, operatori duhet të kërkojë edhe dëshminë e pronësisë ose evidencën, se personi që kërkon lëshimin e automjetit ka qenë duke drejtuar atë para se të bllokohej, përkatësisht para se të jetë tërhequr në vendin e caktuar për këtë.

5.2. Operatorit nuk i lejohet lëshimi i automjetit, kur pronari ose drejtuesi i automjetit jep dëshminë e kërkuar sipas paragrafit paraprak dhe bën pagesën e taksës sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Obligimet dhe përgjegjësitë e operatorit

Neni 6

- 6.1 Operatori është përgjegjës të plotësojë të gjitha dokumentet e nevojshme gjatë kryerjes së sigurimit fizik të autoparkut të Komunës.
- 6.2 Afati për sigurimin e autoparkut zgjatë derisa zgjatë kontrata e tërheqjes.
- 6.3 Operatori është përgjegjës në rast keqpërdorimi, dëmtimi eventual gjatë ngarkimit - shkarkimit, bartjes deri në dorëzimin e automjetit në autoparkun komunal (dëmin eventual të shkaktuar duhet t'ia kompensojë pronarit të automjetit).
- 6.4 Pas dorëzimit dhe vendosjes së automjetit në parkingun komunal, përgjegjësia bie mbi personelin e sigurimit të autoparkut deri të bëhet tërheqjen e automjetit nga pronari.

Kushtet për shërbimin e transportit me “merimangë”

Neni 7

Operatori i cili ushtron këtë veprimtari, duhet t'i plotësojë këto kushte:

- 7.1. të jetë i regjistruar për ushtrimin e shërbimit të transportit me “merimangë”,
- 7.2. të ketë së pakut dy automjete për bartjen e automjeteve,
- 7.3. të ketë sistemin funksional të radio-lidhjeve,
- 7.4. të sigurojë shërbimin 24-orësh, gjatë shtatë ditëve të javës,
- 7.5. të ketë në dispozicion linjë telefonike,
- 7.6. të ketë numër të mjaftueshëm të personelit për ushtrimin e veprimtarisë (për një automjet për bartje të ketë ngasësin dhe ndihmësin).

Kushtet për automjetet bartëse

Neni 8

Automjetet duhet:

- 8.1 të jenë të regjistruara,
- 8.2 të jenë të dedikuara posaçërisht për bartjen e automjeteve, (njëri automjet duhet të jetë me vinç, të ketë katër mengenetë, të cilat duhet të vendosen në rrota të automjetit, kurse tjetri duhet të jetë me litar tërheqës (metalik), që ta bëjë ngarkimin e veturave),
- 8.3 të kenë xhokerë, nga dy copa për automjetet automatike dhe automjetet (4 x 4),
- 8.4 të mos jenë më të vjetra se katër vjet nga regjistrimi i parë në Kosovë, Përparësi do të kenë operatorët, të cilët i kanë automjetet më te reja në vitin e prodhimit,
- 8.5 është e preferuar të kenë ngjyrë të njëjtë,

- 8.6 në çdo kohë, të jenë në gjendje teknike të rregullt,
- 8.7 'i kenë pajisjet e parapara për ushtrimin e kësaj veprimtarie,
- 8.8 të kenë dritën rrotulluese me ngjyrë të verdhë të vendosur mbi automjet dhe
- 8.9 të kenë shenjat përkatëse të komunikacionit.

Kushtet për drejtuesit e automjeteve

Neni 9

Drejtuesit e automjeteve duhet:

- 9.1. të jenë në marrëdhënie pune te operatori,
- 9.2. të kenë patentën e shoferit të kategorisë përkatëse për drejtimin e automjetit përkatës,
- 9.3. të kenë ndihmësin për kryerjen e bartjes.

Tarifa e shpenzimeve

Neni 10

10.1 Tarifa e shpenzimeve për zhvendosjen e automjeteve, bllokimit dhe zhbllokimit, si dhe ruajtja në vendin ku vendosen, është e përcaktuar si në vijim :

- 1. Për zhvendosjen e motoçikletës, traktorit dhe veturës pa rimorkio brenda qytetit, deri në vendin për vendosje dhe ruajtjen e tyre deri në 24 orë, tarifa e shpenzimeve është tridhjetë (30) €.
- 2. Tërheqja e automjetit transportues, rimorkios ose gjysmë rimorkios dhe autobusit brenda qytetit, deri në vendin për vendosje dhe ruajtja e tyre deri në 24 orë, kushton njëqind (100) €.

10.2 Zhvendosja e automjeteve nga paragrafi 1 i pikës 10.1, nga zona jashtë qytetit, pa ngarkesë, kushton 0.25 € për 1 km, ndërsa me ngarkesë 0.50 € për 1 km. Të njëjtat tarifa vlejnë edhe për paragrafin 2. të pikës 10.1.

10.3. Në rastin kur zhvendosja e automjetit vetëm fillon, por nuk bëhet zhvendosja deri në vendin e ruajtjes, zbatohet çmimi si vijon: në zonën urbane 15 €, ndërsa jashtë zonës urbane zbatohet paragrafi 2 i pikës 10.1.

10.4. Kur automjeti i zhvendosur, pas kalimit të kohës prej njëzetekatër orësh, nuk merret nga pronari ose shfrytëzuesi, siç përcaktohet në këtë Rregullore, ruajtja, përkatësisht qëndrimi i mëtutjeshëm i automjetit për një ditë qëndrimi dhe ruajtje, do të paguhet çmimi prej 5 €.

10.5. Për zhbllokimin e automjeteve, autobusëve, automjeteve transportuese, automjeteve të punës dhe rimorkiove, duhet paguar 15 €.

10.6 Kur automjeti i bllokuar, pas kalimit të kohës prej njëzetekatër orësh, kur pronari ose shfrytëzuesi i automjetit nuk përmbush detyrimet për zhbllokimin e automjetit siç

përcakton kjo Rregullore, ruajtja, përkatësisht qëndrimi i mëtutjeshëm i automjetit nën bllokim, për një ditë qëndrimi dhe ruajtje duhet paguar 5 €.

10.7. Të gjitha pagesat nga paragrafi paraparak do të bëhen përmes bankës, si të hyra të Komunës;

10.8. Taksat e shërbimeve do t'i vërtetojë Drejtoria e Financave dhe Pronës.

10.9 Për secilën pagesë do të lëshohet fatura, e cila do të jetë me numër rendor dhe do të përmbajë këto të dhëna:

- markën dhe modelin e automjetit,
- numrin e targave,
- emrin e plotë, adresën dhe numrin personal të personit që i lirohet automjeti,
- datën e bllokimit të automjetit,
- datën e lirimit të automjetit dhe vendin e lirimit (në vendqëndrimin e automjeteve apo në vendin ku është bllokuar).

Puna me bllokues

Neni 11

11.1 Sipas kësaj Rregulloreje, operatori i licencuar nga Komuna duhet të jetë i pajisur me bllokues.

11.2. Sistemi i vendosjes së bllokuesve kryhet nga punëtorët e operatorit, në marrëveshje me policinë, në çdo kohë dhe në çdo vend.

11.3. Automjetit të cilit i vendosen bllokuesit, duhet të paguajë gjobën sipas nenit 10, paragrafi 10.5 të kësaj Rregulloreje.

11.4. Në rast se pronari, përkatësisht drejtuesi i automjetit largon automjetin para se të arrijnë punëtorët për vendosjen e bllokuesve, ai paguan gjobën sipas nenit 10, paragrafi 11.3 të kësaj Rregulloreje.

E drejta për ankesë

Neni 12

12. 1. Kundër urdhëresës për zhvendosje ose bllokim të automjeteve, pronari ose poseduesi i automjetit ka të drejtë ankesë.

12.2 Nëse ankesa miratohet si e bazuar, ankuesit do t'i bëhet kompensimi i shumës së paguar për zhvendosje ose bllokimin e automjetit, sipas dispozitave të parapara në këtë Rregullore.

Lirimi nga tarifa e pagesave

Neni 13

13.1 Nga pagesa lirohen:

- automjetet e zhvendosura ose automjetet që tërhiqen me rastin e konfiskimit nga ana e Policisë, me qëllim të verifikimit të dokumentacionit dhe të automjetit, në rast se verifikimi rezulton i rregullt;
- automjetet e zhvendosura ose që tërhiqen, në rastet kur automjeti ka pësuar aksident dhe si pasojë ka ardhur deri te vdekja e personave në automjet dhe
- automjetet e tërhequra nga Policia për shkaqe sigurie.

13.2. Si dëshmi e plotësimit të këtyre kriterëve të paragrafit paraprak, Policia, gjatë plotësimit të raportit, duhet shënuar arsyen e tërheqjes - marrjes së automjetit.

13.3. Nëse me vendim të Gjykatës verifikohet rregullsia e dokumentacionit dhe automjetit të konfiskuar nga ana e Policisë, të cilin dokument pronari ose shfrytëzuesi i automjetit duhet ta sjellë me rastin e ushtrimit të kërkesës për lirim e automjetit.

13.4. Drejtoria (personi i autorizuar i DSHP) do t'i kontrollojë në vazhdimësi të dhënat e operatorit lidhur me shërbimet e bëra, pajisjet, sigurimin e objektit, listën mujore të tërheqjes dhe vendin për parkim. Drejtoria ka të drejtën e kontrollit të të dhënave edhe pas skadimit apo të ndërprerjes së kontratës, në periudhë prej 5 (pesë) vitesh.

13.5. Sipas kërkesës së Drejtorisë, operatori obligohet që të sjellë faturat dhe llogarinë mujore, sipas nenit 10 të kësaj Rregulloreje.

Automjetet e braktisura

Neni 14

14.1. Automjetet e braktisura, të cilat shihet se nuk janë në gjendje të rregullt teknike, kur i mungojnë pjesët qenësore të automjetit (pa motor, goma, parafango etj.), zhvendosen me urdhëresën e zyrtarit policor pas kërkesës së zyrtarëve të Komunës (inspektorëve komunalë dhe të komunikacionit), këto automjete zhvendosen në depon e mbeturinave.

14.2. Shpenzimet e zhvendosjes së automjetit në depon e mbeturinave i bart pronari i fundit i automjetit, nëse kjo mund të konstatohet në bazë të të dhënave të regjistrimit të automjetit nga evidenca e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në të kundërtën, bie në barrë të Komunës, zyrtarët e së cilës bëjnë kërkesën për zhvendosje.

14.3. Para se të bëhet zhvendosja e automjeteve të braktisura, operatori i licencuar nga Komuna për zhvendosjen e automjeteve, përmes ekspertit përkatës, konstaton vlerën reale kushtuese të automjetit.

Neni 15

Në rast të shkeljes së ndonjëres nga dispozitat e kësaj Rregulloreje, Drejtoria mban të drejtën e shkëputjes së kontratës me operatorin.

II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 16

Për të gjitha çështjet tjera, të cilat nuk janë paraparë në këtë Rregullore, do të zbatohen dispozitat e Ligjit nr. 02/L - 70, për sigurinë në komunikacionin rrugor dhe dispozitat e Udhëzimit administrative nr. 02/2009 - PK.

Neni 17

Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për shërbimin e transportit me "Merimangë", 01. nr. 344 - 316 e dt. 30.6.2006.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. Nr. 110-1205 më 16.06.2010

KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS

Sami Hamiti, ecc. i dipl.